



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KOMERCIALE E E KOSOVËS
DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË

Numri i lëndës: 2020:092272
Datë: 28.03.2024
Numri i dokumentit: 05524620

Kom.Dh.Sh.II.nr.1122/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Dren Rogova, kryetar i kolegjit, Ramush Bardiqi dhe Krenar Berisha, anëtarë të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit N.T.P “Bislimi” me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson N.S. avokat në Prishtinë, kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit të ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti Administrativ – Divizioni Fiskal, A.nr.1299/20 të datës 15.02.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 28.03.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET si e bazuar ankesa e të paditurës Dogana e Kosovës, me seli në Prishtinë, NDRYSHOHET Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.1299/20 i datës 15.02.2022 dhe gjykohet si vijon:

1. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësit N.T.P “Bislimi” me seli në Prishtinë dhe ANULOHET vendimi i të paditurës Dogana e Kosovës nr.06.02/158 i datës 18.02.2020 si dhe aktvendimi 03.1.3-2017-7/1 i datës 09.02.2017.

2. Obligohet e paditura Dogana e Kosovës në Prishtinë që paditësit N.T.P “Bislimi” me seli në Prishtinë, t’ia kthej shumë e paguar në emër të kundërvajtjes doganore në vlerë prej 2,500.00€ (dy mijë e pesëqind euro), në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti Administrativ – Divizioni Fiskal, me aktgjykimin e ankimuar, ka Refuzuar kërkesëpadinë e paditësit N.T.P “Bislimi” me seli në

Prishtinë, si të pabazuar në ligj, dhe ka lënë në fuqi aktvendimin e të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë nr.06.2/158/2017 të datës 06.07.2020.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë ka ushtruar përfaqësuesi i autorizuar i paditësit, me të cilin e konteston ligjshmërinë e tij, për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozimin që ankesa e paditësit të aprovohet si e bazuar dhe të ndryshohet nën tërësi Aktgjykimi i Gjykatës Themelore A.nr.1299/20, në atë formë që të aprovohet kërkesëpadia e paditësit dhe anulohet vendimi i të paditurës Aktvendimi me nr.06.2/158/2017 i datës 06.07.2020.

Gjykata Komerciale-Dhoma e shkallës së Dytë, vlerësoi ligjshmërinë e aktgjykimit të kontestuar si në vështrim të nenit 12 të Ligjit 08/L-015 dhe nenit 49 të LKA, në drejtim të theksimeve në ankesë dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave tjera të lëndës gjen se:

Ankesa është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me Aktvendimin e organit të paditur nr.06.2/158/2017 të datës 06.07.2020, është refuzuar si e pabazuar kërkesa e subjektit në procedurë, N.T.P “Bislimi” –Prishtinë për rishqyrtimin e aktvendimit nr.03.1.3-2017-7/1 fdt.09.02.2017 të lëshuar nga Drejtoria Rajonale Prishtinë – Njësi i PAKD-së, si e pabazuar.

I pakënaqur me aktvendimin e të paditurit subjekti-tani paditësi, ushtron padi në procedurë të konfliktit administrativ në Gjykatës, duke kundërshtuar aktin administrativ përfundimtar të paditurës të lartcekur. Gjykata e shkallës së parë në këtë çështje, mbanë seancë të shqyrtimit kryesor me datë 15.02.2022, si në bazë të nenit 41 të LKA-së, në prani të përfaqësuesit të autorizuar të palës paditëse e në mungesë të palës së paditur, dhe pas administrimit të provave dhe vërtetimit të gjendjes faktike, gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së aktvendimit të organit të paditur, merr aktgjykimin e ankimuar, me të cilin e refuzon kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar, ndërsa e lënë në fuqi aktvendimin e organit të paditur, sipas theksimeve në arsyetim të aktgjykimit se: Pretendimi i paditësi se në rastin konkret subjekti këtu paditësi nuk ka kundërvajtje, dhe se kemi vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike për Gjykatën është i pa bazuar dhe në kundërshtim edhe me shkresat e lëndës dhe atë me procesverbalin mbi kundërvajtjen administrative doganore nr. 2017-7/09.02.2017, dhe me DUD-in R57117/01.12.2016, për faktin se paditësi në bazë të Mendimit për Klasifikim Tarifor nr. 06/08.02.2017 nuk rezulton të ketë paraqitur dhe deklaruar kodin tarifor e që ka rezultuar me llogaritjen ose pagesën e detyrimeve doganore në shumë prej 2,716.20€ më pak se sa vlera e llogaritur e mallit me kodin tarifor të ndryshuar 5606009100 e i cili kod tarifor përfshin edhe taksën doganore prej 10%, tutje Gjykata ka gjetur se i njëjti mall me të njëjtën vlerë në të cilën është kalkuluar edhe taksa doganore prej 10% për shkak të ndërrimit të kodit tarifor është proceduar tutje si e tillë në Zyrën Doganore Prishtinë, dhe atë me deklaratën unike doganore R-57117/01.12.2016, e cila deklaratë doganore nuk është kontestuar nga paditësi në padi dhe as në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor.

Dhomat e Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale, si gjykatë e shkallës së dytë, sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK e vlerëson aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë brenda kufijve të shkaqeve ankimore të theksuara në ankesë, duke i vështruar sipas detyrës zyrtare shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par. 2 nën pikën b), g), j), k) dhe m) të këtij ligji dhe aplikimin e drejtë të së drejtës materiale.

Dhomat e Shkallës së Dytë gjejnë se aktgjykimi i atakuar është marrë me shkelje të nenit 8 të LPK-së, për arsye se gjykata e shkallës së parë edhe pse i ka vlerësuar të gjitha provat që gjenden në shkresat e lëndës, ka ardhur në konkludime të gabueshme lidhur me gjendjen faktike, duke bërë interpretim të gabueshëm të fakteve të vërtetuara dhe duke mos i vlerësuar në tërësi faktet vendimtare, ashtu që e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit duke u bazuar në procesverbalin mbi kundërvajtje administrative doganore nr.2017-7/09.02.2017 dhe Mendimin për Klasifikimin Tarifor nr.06/08.02.2017 si mjete provuese jo të duhur për faktet vendimtare.

Gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e aktgjykimit thekson se për të dëshmuar klasifikimin e drejtë tarifor të mallit paditësi është dashur që para autoritetit doganor të paraqes Informaten Tarifore Detyruese të lëshuar nga Autoritetet e Bashkimit Evropian, ndërsa në anën tjetër e paditura bazuar në marrjen e mostrave për DUD-in 57117/01.12.2016, ka kërkuar mendim për klasifikim tarifor nga Sektori i Tarifës po në kuadër të Doganës, e i cili Sektor me datë 08.02.2017, ka lëshuar mendimin për klasifikim tarifor nr. 06, e sipas të cilit mendim, kodi tarifore i deklaruar nuk është i duhuri dhe se kodi tarifor i duhur i produkteve kontestuese është [...], kjo bazuar në analizimin e produkteve kontestuese sipas dokumentacionit përcjellës të DUD-it kontestues, rregullave të përgjithshme numër 1 dhe 6 për interpretimin e TARIK-2015, shënimeve shpjeguese të seksionit XI, kapitullit 55 dhe 56 dhe të kërësve 5506 dhe 5606 shpjegimeve plotësuese dhe informatave nga interneti.

Kolegji i kësaj gjykate ka vlerësuar përfundimin e tillë të gjykatës së shkallës së parë dhe ka gjetur se një qëndrim i tillë juridik nuk mund të pranohet si i drejtë dhe i ligjshëm sepse sipas vlerësimit të kësaj gjykate mbi gjendjen e tillë faktike gabimisht është zbatuar e drejta materiale, kur gjykata e shkallës së parë ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar, sepse gjykata e shkallës së parë vendimin e saj e ka mbështet në fakte jo relevante dhe me interpretim të gabuar të dispozitave ligjore.

Dhomat e Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale erdhën në përfundim se gjykata e shkallës së parë vendimin e saj e ka nxjerr duke mos e zbatuar në mënyrë të drejtë dispozitën ligjore nga neni 276 pika k), me të cilën përcaktohet se: *“Personi juridik apo fizik: është përcaktuar qartë se “Në qoftë se, në Deklaratën Unike Doganore në mënyrë të rrejshme, të pasaktë apo jo të plotë shënon sasinë, cilësinë, llojin, kodin tarifor, vlerën apo origjinën e mallit ose nuk e përfshin tërë mallin, që ka rezultuar me llogaritjen ose pagesën e borxhit doganor në shumë më të vogël nga ajo reale”, do të gjobitet me gjobë në të holla në shumë prej pesëmijë (5.000) deri në dhjetëmijë (10.000) €”*. Në rastin konkret gjykata e shkallës së parë nuk ka vërtetuar drejt gjendja faktike

pasi që vendimi kontestues dhe vendimi për shpalljen përgjegjës të paditësit për kryerje të kundërvajtjes doganore nga neni 276 pika k) e KDAK-së, nuk i ka marr parasysh dokumentet përcjellëse të mallit siç është deklarata eksportuese dhe deklarimi i eksportuesit nga Turqia e ku figuron kodi tarifor i mallit lëndor me nr.5502000, ashtu si edhe e ka deklaruar paditësi. Kolegji i kësaj gjykate konsideron se sikur paditësi për mallin e importuar të deklaronte kod tjetër tarifor nga ai deklaruar sipas dokumentacionit përcjellës, i njëjti në atë situatë do të mund të shpallej përgjegjës për kryerje të kundërvajtjes doganore nga neni 276 pika k) e KDAK-së, sepse ai kod i deklaruar do të ishte jo i saktë në raport me dokumentacionin e prezantuar. Ndërsa në rastin konkret kodi tarifor i prezantuar nga paditësi, është i njëjtë me kodin tarifor të prezantuar në dokumentet përcjellëse të mallit, prandaj edhe pretendimi të të paditurës se paditësi ka kryer kundërvajtje doganore nga neni 276 pika k) e KDAK-së për kolegjin e kësaj gjykate është i pabazuar.

Bazuar në të lartcekurat dhe nga fakti se në shkresat e lëndës ka prova të mjaftueshme për vërtetimin e plotë të gjendjes faktike, Kolegji i kësaj Gjykate vlerëson se gjykata e shkallës së parë mbi gjendjen faktike gabimisht e ka zbatuar të drejtën materiale kur ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar, andaj është dashtë që aktgjykimi i atakuar të ndryshohet, të aprovohet kërkesëpadia e paditësit, të anulohet aktvendimi kontestues i të paditurës Dogana e Kosovës dhe të obligohet e paditura që paditësit N.T.P “Bislimi” me seli në Prishtinë, t’ia kthej shumë e paguar në emër të kundërvajtjes doganore në vlerë prej 2,500.00€ (dy mijë e pesëqind euro).

Nga të cekurat konform Nenit 195.1 pika e) dhe 201 b) të LPK-së u vendos si ne dispozitivin e këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE PRISHTINË
Dhomat e Shkallës së Dytë
Kom.Dh.Sh.II.nr.1122/22 datë 28.03.2024

Kryetar i kolegjit, gjyqtari
Dren Rogova